

# STATUTI

I

## SHOQËRISE “ NT Konstruksion ” sh.p.k.

Mbështetur ne Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, neve Artan Indrisllari dhe Lunardi Haka , Ortake te Shoqerise “NT Konstruksion” sh.p.k., sot më datë 11/01/2023, nënshkruajnë Statutin e Shoqerise “NT Konstruksion” sh.p.k., i cili përcakton objektin, të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë.

Ortakët themelues janë:

1. Lunardi Haka, i datelindjes 29.11.1989, lindur ne Kruje dhe banues ne Nikel ,Fushe Kruje.
2. Artan Indrisllari, i datelindjes 21.09.1975., lindur ne Staravecke dhe banues ne Ksamil Sarande,

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### NENI 1

##### KRIJIMI, EMËRTIMI DHE SELIA E SHOQËRISË

2.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është krijuar me Aktin e themelimit dt. 11.01.2023 të nënshkruar nga ortaket themelues të shoqërisë dhe eshte e Regjistruar ne daten 12.11.2023.

2.2 Shoqëria emërtohet “NT Konstruksion” sh.p.k.

Selia e shoqërisë ndodhet në adresen : Ksamil, Bashkia Sarande, Rruga “Riza Cerova” -04380059, Nr. i Pasurise 3/1177 , Zona Kadastrale 2297,Ndertesa 11 me ID 555009,Hyrja 1, shtepi private, Kodi Postar 9706.

2.3 Shoqëria “NT Konstruksion” shpk ka të drejtë të përdorë vulën e saj në formën që ajo disponon, me madhësi të zakonshme dhe me mbishkrimin “NT Konstruksion ” shpk. dhe adresën.

2.4 Veprimtaria dhe funksionimi i shoqërisë do të rregullohet nga legjislacioni në fuqi dhe nga statuti i saj.

2.5 Shoqëria “NT Konstruksion” mund të krijojë degë apo filial në vartësi të saj.

#### NENI 2

##### REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

2.1 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

2.2 Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kontratës së themelimit, Statutit dhe dispozitave të legjislacionit tregëtar e atij civil në fuqi.

2.3 Me vendim të ortakëve, Shoqëria mundet që të ndryshojë formën e regjimit juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e aktit të themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

2.4 Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në QKR.

2.5 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

### NENI 3

#### OBJEKTI I SHOQËRISË

3.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- a. Aktivitet ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme me destinacion banimi dhe biznesi
- b. Aktivitet ne fushen e turizmit, te hotelerise dhe ndermjetesimit te aktivitetit turistik.
- c. Aktivitet ne fushen e tregetimit te makinerive te ndryshme profesionale , te reja dhe te perdorura .

### NENI 4

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj pa afat. Aktiviteti i shoqërisë fillon pas regjistrimit të shoqërisë në QKB.

### NENI 5

#### KAPITALI THEMELTAR

5.1 Kapitali themeltar i nënshkruar është 100.000 lek ( njëqindmije) leke, i cili përbëhet nga kontributi vetëm në para. Ky kapital i cili përbëhet nga 2pjesë është nënshkruar nga të dy ortakët e saj themelues.

5.2 Shoqëria tregëtare do të ketë dy ortakë të saj, ku ortaku Z.Artan Indrisllari do të zotëroj 50% të kuotave të kapitalit themeltar ,ose 1 kuote, ku vlera nominale e një kuotë është 50.000 lekë ndërsa ortaku tjetër Z. Lunardi Haka do të zotëroj 50% të kuotave të kapitalit themeltar ose 1 kuote të barabarta, ku vlera nominale e një kuotë është 50.000 lekë.

5.3 Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar.

5.4 Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë veprimtarisë së saj janë në pronësi të ortakëve, në raport me përqindjet e kapitalit themeltar që ata zotërojnë. Pasuritë e shoqërisë mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng në hipotekë me miratimin e ortakëve.

### NENI 6

#### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

6.1 Ortakët japin kontributin e tyre në Shoqëri në para ose në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

6.2 Personat përgjegjes për administrimin e Shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë të Shoqërisë Tregëtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet tu vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së Shoqërisë Tregëtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit sekretit tregëtar i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të paautorizuar do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregëtare të shoqërisë.

6.3 Ortaket kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin kapitalin e tyre, në përputhje me kushtet që lejon Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

6.4 Heqja dorë nga Shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që kanë ata deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk i çënon ata në marrjen e të ardhurave që shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

6.5 Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime dhe trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortaket respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e veprimtarisë së Shoqërisë sipas objektit të saj.

## NENI 7

### LARGIMI I ORTAKUT NGA SHOQËRIA DHE LIKUJDIMI I KUOTËS

7.1 Ortaku mund të largohet nga Shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkaqet e largimit.

7.2 Administratori duhet të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do ti likujdohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likujdimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likujdimin e kuoteës.

## NENI 8

### KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

Funksionimi i shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

## NENI 9

9.1 Kapitali fillestar i investuar nga ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themelor të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon ortakëve dokumentin vërtetues për sasinë e shumave të derdhura në fazën e themelimit.

9.2 Vlerësimi i kapitalit në natyrë është bërë nga ortakët themelues në momentin e themelimit të shoqërisë.

#### NENI 10

##### PASURIA E SHOQËRISË

Shoqëria bëhet pronare e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, kur vlera e pasurisë mbulohet tërësisht në të holla.

#### NENI 11

##### PRONËSIA MBI KUOTAT

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë:
- Shit – blerjes:
- Trashëgimisë:
- Dhurimit:
- Në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

#### NENI 12

##### E DREJTA E PARABLERJES

Pavarsisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, për çdo transferim të kuotave është i nevojshëm miratimi i asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes.

#### NENI 13

##### FORMA E TRANSFERIMIT

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

#### NENI 14

Kuotat mund të anulohen në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhen me anullimin e tyre. Rastet e anullimit të kuotës do të përcaktohen me rregullore të posaçme, të miratuara nga Asambleja e Ortakëve.

#### NENI 15

##### ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

15.1 Kapitali themelor mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së përgjithshme me një maxhorancë 3/4 e saj.

15.2 Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të ortakëve.

15.3 Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

#### NENI 16

##### FONDET REZERVË

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballur nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

#### NENI 17

##### PËRDORIMI I TE ARDHURAVE NETO

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen në çdo lloj veprimtarie nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimit, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

#### NENI 18

##### BILANCI

18.1 Pasuria e shoqërisë vlerësohet nga bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

18.2 Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga administratori në harmoni me format e bilanceve të parashikuara nga legjislacioni në Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 19

##### PLANI FINANCIAR

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

#### NENI 20

##### SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

#### NENI 21

##### KUFIZIMI I SHPËRNDARJEVE TË FITIMEVE

21.1 Shoqëria mund tu shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj:
- b) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

21.2 Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

21.3 Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.

21.4 Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese. Administratori, që nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

21.5 Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividende, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

## ORGANET E SHOQERISE

### NENI 22

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME E ORTAKËVE

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Asambleja e përgjithshme merr vendime për :

1. Përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë:
2. Ndryshimet e statutit:
3. Emërimin e shkarkimin e administratorëve:
4. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar:
5. Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesit dhe ekspertët kontabel të autorizuar:
6. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë:
7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë:
8. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit:
9. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre:
10. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve:
11. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë:
12. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë:
13. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

### NENI 23

23.1 Asambleja e përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

23.2 Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- Shoqëria, brenda dy viteve të para pas rregjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

23.3 Asambleja e përgjithshme mbledhet në selinë e shoqërisë.

#### NENI 24

##### THIRRJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

24.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

24.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### NENI 25

##### KUORUMI I NEVOJSHEM DHE VENDIM-MARRJA

25.1 Në rastin e vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votive janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

25.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës të kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

25.3 Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërta të votave të ortakëve pjesmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin e prishjen e shoqërisë. Për çështje të tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesmarrës.

25.4 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

25.5 Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë të kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërbllimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave.

#### NENI 26

## PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE

26.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në proces verbal. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të proces verbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

26.2 Proces verbali duhet të mbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit të përbajtësit të proces verbalit, rezultatet e votimit.

26.3 Proces verbalit i bashkangjitet dhe lista e pjesmarrësve si dhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

26.4 Proces verbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i proces verbalit.

## NENI 27

### HETIMET E POSACME

27.1 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posacëm për parregullsi përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregëtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

27.2 Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe ose cilido kreditor i shoqërisë mund ti kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, ku ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund ti kërkoj gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

27.3 E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e rregjistrimit të shoqërisë tregëtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregëtare.

## ADMINISTRIMI I SHOQERISE

## NENI 28

### ADMINISTRATORI I SHOQERISE

28.1 Shoqëria do të administrohet nga administratori i shoqërisë. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

28.2 Administratori i shoqërisë është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë të punësuarve në shoqëri.

28.3 Administratori Shoqërisë është Z. Lunardi Haka

## NENI 29

### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT

29.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme:



- Përfaqësojë shoqërinë tregëtare me të tretët:
- Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë:
- Përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim:
- Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë:
- Kryejë rregjistrimet dhe të dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për QKR:
- Raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare:
- kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut:
- Të thërrasi asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda dy viteve të para pas rregjistrimit të saj, propozon të blej nga në ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda tre muajve në vazhdim.

29.2 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

29.3 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrdhënieve kontraktore me shoqërinë rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

29.4 Në rast kur administrator i shoqërisë jep dorëheqje ose shkarkohet, ai do të ushtrojë funksionet e tij deri në emërimin e një administratori tjetër.

## NENI 30

### SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

30.1 Shpërblimit bazë të administratorit mund ti bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorit përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë të përgjithshme.

30.2 Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

30.3 Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

30.4 Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregëtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

## NENI 31

### MARREVESHJET NDERMJET SHOQERISE DHE ADMINISTRATORIT

31.1 Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe administratorit të shoqërisë, qoftë e drejtpërdrejt ose jo, duhet ti nënshtrohet autorizimit paraprak të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

31.2 Ky nen nuk është i zbatueshëm për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhëse të shoqërisë që kryhet në kushte normale.

31.3 Administratori i shoqërisë duhet të njoftojë asamblenë e përgjithshme të ortakëve për një marrëveshje për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statutit. Nëse administratori i shoqërisë është një nga ortakët ai nuk merr pjesë në votim për dhënien e autorizimit.

## NENI 32

### EKSPERTET KONTABEL

32.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi para rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën asambleja e përgjithshme.

32.2 Ekspertët kontabel mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

32.3 Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

## MARDHENIET E PUNES

### NENI 33

33.1 Marrdhëniet e punës në shoqëri rregullohen sipas dispozitave të aktit të themelimit, statutit të shoqërisë dhe legjislacionit shqiptar të punës.

33.2 Punësimi në shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis shoqërisë e të punësuarve. Marrdhëniet midis shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

### NENI 34

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativë janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj individualisht.

## PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

### NENI 35

#### PRISHJA E SHOQERISE

Kjo shoqëri do të priset në rast kur:

1. Merr vendim asambleja e përgjithshme.
2. Hapen procedurat e falementimit.
3. Nuk ka kryer veprimtari tregëtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me piken 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit"
4. Merret një vendim gjykatë.

### NENI 36

## LIKUIDIMI I SHOQERISE

36.1 Prishja e shoqërive tregëtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

36.2 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

36.3 Çdo person i interesuar ka të drejtë ti kërkoj gjykatës zevëndësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cënohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

36.4 Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria priset me vendim gjykate.

36.5 Likuiduesit shkarkohen dhe zevëndësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

36.6 Administratori i shoqërisë i njofton për regjistrim, QKR të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit njoftojnë, gjithashtu, QKR për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.

36.7 Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj.

36.8 Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emërimit të tij.

## NENI 37

### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E LIKUIDUESIT

37.1 Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar rradhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

37.2 Likuiduesi mund të kryej edhe veprime të tjera tregëtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregëtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e ti kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

## NENI 38

### BILANCET

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi, përgatit pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga asambleja e përgjithshme.

## NENI 39

### SHPERNDARJA E AKTIVEVE

39.1 Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve.

39.2 Pasuritë që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve.

39.3 Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi njofton QKR për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çrregjistrimin e shoqërisë.

#### NENI 40

##### LIKUIDIMI I THJESHTËZUAR

40.1 Shoqëria mund të likujdohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë para gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrdhëniet me punëmarrësit.

40.2 Administratori njofton për rregjistrim pranë QKR vendimin për likuidimin e shoqërisë nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

40.3 Administratori është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përvec administratorit, ortakët e shoqërisë përgjigjen në menyrë solidare deri në shumat e marra.

#### NENI 41

##### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin mes shoqërisë dhe të tretëve apo midis ortakëve të saj, nuk zgjidhen me mirëkuptim, ose në rrugë administrative, palët kanë të drejtë ti drejtohen për zgjidhje organeve gjyqësore.

#### DISPOZITA TE FUNDIT

#### NENI 42

##### HYRJA NE FUQI

Ky statut hyn në fuqi pas miratimit nga asambleja e përgjithshme e ortakëve dhe rregjistrimit në Regjistrin Tregëtar pranë QKR.

#### NENI 43

Gjithshka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregëtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 44

Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, u lexua dhe u firmos me vullnet të lirë e ndërgjegje të plotë nga dy ortakët themelues të shoqërisë "NT Konstruksion" shpk sot më datën 11/01/2023.

ORTAKET

Dunoxdi Malca

Artan Zndrisllari